REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-2287/26 datë: 17.06.2026

Npi – 01/147 datë: 26.06.2026

Bazuar në nenin 40.2. pika (d), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Në Ligjin Nr.05/L-055, për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.17/10, Qershor 2016); Nenin 14 të Rregullores së Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit Nr.01/02-1163 e datës 21.06.2019. Kuvendi Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më: 26.06.2026, mori këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT NGA RAPORTI VJETOR I AUDITIMIT TË PASQYRAVE VJETORE FINANCIARE 2025 PËR KOMUNËN E SHTIMES

I

Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -V- të rregullt për vitin 2026, të mbajtur më datën: 26.06.2026 me shumicën e votave miratoi, Planin e Veprimit nga Raporti Vjetor i Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare 2025 për Komunën e Shtimes.

II

Raporti është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, Npi-01/139 dt.25.06.2026.

III

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Zyrës për Financa, Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrisë për Financa, dhe Zyrës për Informim.

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SHTIMES-OPŠTINA ŠTIMLJE
SHTIME-ŠTIMLJE

V.v.

Kryesuesi i Kuvendit
Rrahman Jakupi